

PAOLO MUNER

*JO VETËM “HYMNI I FLAMURIT”*

*Disa kuriozitete mbi “himnet e tjera kombëtare” shqiptare, në prag të Pavarësisë.*

*NON SOLO “INNO DELLA BANDIERA”.*

*Qualche curiosità su altri “inni nazionali” albanesi, agli albori dell’indipendenza.*

*Shqipëruar nga Italishtja Albana Nexhipi*

*Botimet : JOZEF-DURRËS*

*ISBN:978-9928-189-16-5*

*Ky botim dy gjuhësh bëhet i mundur falë sponsorizimit të Shkollës së Lartë Universitare “Wisdom’ Tiranë.*

*Se Zoti vet e tha me gojë*

*Që kombe shuhen përmbi dhe*

*Po Shqipëria do të rrojë,*

*Për të, për të luftojmë ne.*

*Falenderojmë Paolo Muner-in, që ka shkuar të kërkojë sërish , si një i pasionuar vërtet evropian të Shqipërisë, edhe përmes origjinës së himneve kombëtare.*

*Wisdom University ka kuruar në të shkuarën edhe botimin dy gjuhësh të Statuteve të Shkodrës, prej nga rrjedhon që Shqipëria ka qenë absolutisht në qendër të zhvillimit juridik, civil e ekonomik të kontinentit tone, qysh prej 1300-ës.*

*Është në traditën e këtij populli ruajtja e vlerave historike të një Evrope, së cilës qysh më 1400-n i mbrohej pavarësia dhe parimet themelore nga një hero shqiptar, Gjergj Kastriot Skënderbeu, i cili, në shenjë mirënjohje universal, është kthyer në ikonë të Evropës sonë.*

*Viti 2012 ishte, siç e dimë tejet i rëndësishëm për Shqipërinë dhe shqiptarët, për të gjithë shqiptarët më mire, se celebroi njëqind vjetorin e parë të Pavarësisë së Shqipërisë.*

*Në të tillë kontekst spikatën veçanërisht dy elemente kombëtare, simbole të mirëfillta: Flamuri dhe Himni.*

*Janë dy elemente që kanë një vlerë absolutisht kryesore për çdo komb, por për shqiptarët mund të themi edhe më shumë. Pra, nuk është aspak rastësi që 28 Nëntori, festa e tyre kombëtare, dita e shpalljes së Pavarësisë, quhet edhe Dita e Flamurit, dhe Himni Kombëtar, “Himni i Flamurit”, është luajtur për here të parësi i tillë- pikërisht më 1912-n.*